



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 1, datë 29.01.2020

**PËR**

**MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TE NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI  
I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6 % DHE FONDI  
NGA TË ARDHURAT E BASHKISË , PËR MUAJIN JANAR 2020.**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligji Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 99, datë 3.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, Ligjit Nr. 57/2019, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 4.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike“, VKB nr. 593 datë 11.03.2019 “Për miratimin e kriterëve, për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, si dhe për ato, që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor”, VKB nr.647, datë 23.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2020 si dhe Projekt-Buxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2020-2022”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, me propozim të Zëvendës Kryetarit Bashkisë z. Zhuljen Varfaj, i cili kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Të përfitojnë Ndihmë Ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë Durrës – 86 - familje me një fond 291.120 lekë.
2. Të përfitojnë nga Ndihmë Ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar - familje me një fond - lekë. Ky fond do të jetë nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike.
3. Heqjen nga Skema e Ndihmës Ekonomike për këtë muaj gjithsej-2-familje nga fondi i Bashkisë për arsyet e mëposhtme :

A. Njësia Administrative Nr.1

- Myzejen Muzhaqi Përfiton pension pleqërie.

B. Njësia Administrative Nr.2

- Flamur Maloku Mungesë dokumentacioni .
4. Mos miratimin në listën e skemës së ndihmës ekonomike të -0- familjeve, që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara, me Ligjin Nr.57/2019, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, me Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 593, datë 11.03.2019 “Për miratimin e kriterëve, për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, si dhe për ato, që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor”.
  5. Për muajin Janar 2020, futjen në skemën e ndihmës ekonomike të -3 -familjeve, të cilat janë familje në nevojë, në kushte të vështira ekonomike, me probleme të ndryshme sociale dhe do të trajtohen me fond të veçantë nga Bashkia Durrës.
    - Përparim Muhametaj . Familje në nevojë
    - Elmi Gjyshi Familje në nevojë
    - Idaet Coniku Familje në nevojë
  6. Rihyrje në skemën e ndihmës ekonomike me fond nga Bashkia 0- familje.
  7. Rihyrje në skemën e ndihmës ekonomike deri në 6 % e fondit të kushtëzuar -0-familje.
  8. Për muajin Janar 2020, të jenë përfitues të N.E deri në 6% të fondit të kushtëzuar - familje :
  9. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social në varësi të Bashkisë Durrës.
  10. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore“).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 30.01.2020**